



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 8.10.2020

Lënda: Konkluzione përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 8.10.2020, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Peka.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore publike të datës 2.10.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor dhe ftoi palët të paraqesin konkluzionet përfundimtare më datë 8.10.2020. Komisioneri Publik, së bashku me konkluzionet përfundimtare, do të shprehë qëndrimin e tij edhe në lidhje me provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me analizën financiare, gjithsej 16 akte.

I. Vlerësimi i 16 akteve të reja

1. Për vitin 2005

1.1. Akti i paraqitur, komunikim nëpërmjet postës elektronike, i datës ***.9.2020, me dërgues ***.***, motra e subjektit, marrës ***.***, bashkëshortja e subjektit, shoqëruar me fotokopje të kartës së identitetit të znj. ***.***, nuk lexohet data e lëshimit të saj (gjithsej 2 fletë). Znj. *** deklaron se i vëllai dhe bashkëshortja e tij, në periudhën ***.8.2005 – ***.8.2005 kanë qëndruar në shtëpinë e saj në Bruksel, Belgjikë.

1.1.1. Dokumenti shoqërues i deklaratës nuk jep të dhëna për vitin 2005, nëse e motra ka jetuar në adresën e dhënë në periudhën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, ndaj dhe nuk provohet pretendimi se shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit janë mbuluar nga motra e tij. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky dokument nuk provon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, kështu që shpenzimet e udhëtimit të llogariten sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji¹. Komisioneri Publik pranon që akomodimi duhet t'i llogaritet subjektit të rivlerësimit duke marrë parasysh marrëdhënien familjare vëlla dhe motër.

1.2. Në lidhje me të ardhurat nga paga e bashkëshortes, subjekti pretendon se: “Për vitin 2005, në zërin “të ardhura nga paga e bashkëshortes” nuk janë përfshirë: (i) paga e muajit korrik, në vlerën 12.928 lekë; (ii) orët e punës tej kohës normale të punës, në vlerën 6.602 lekë;

¹ Referuar vendimit të Kolegjit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019 (faqe 26 e në vijim).

(iii) shpërblim në fund të vitit, në vlerën 61.622 lekë. Duke pretenduar se shumatorja e këtyre të ardhurave, në vlerën prej 81.152 lekë, duhet t'i shtohet totalit të të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortes për vitin 2005". Komisioneri Publik, referuar akteve në dosje, mbi të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, dorëzuar në ILDKPI, bashkëlidhur deklaratës "Vetting", konkretisht shkresës nr. *** prot., datë ***.10.2016, të Kryeministrit dhe listëpagesës së detajuar bashkëlidhur kësaj shkrese, konstaton se paga neto nga Kryeministria, e znj. ***, për vitin 2005, është 452.780 lekë². Në listëpagesën e detajuar përfshihen të ardhurat nga: pagat, shpërblimet, orët jashtë orarit dhe raport leje lindje për çdo muaj, për periudhën tetor 1997 – tetor 2016. Pra, pretendimi i subjektit se të ardhurat e bashkëshortes për vitin 2005 duhet të shtohen në shumën 81.152 lekë, të përfituara në formë page, orë jashtë orarit të punës dhe shpërblime, nuk qëndron, pasi këto pagesa janë të përfshira në listëpagesën e detajuar.

- 1.3. Në lidhje me depozitën prej 3.000 USD, subjekti pretendon se: "Depozita prej 3000 USD është mbyllur në datën 31.12.2004 dhe këto të ardhura janë konsumuar në vitet e ardhshme...". Referuar detyrimin ligjor që rrjedh nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, subjekti ka pasur detyrim ligjor ta deklaronte në DV – 2004 dhe në vitet në vazhdim për shtesat apo pakësimet e likuiditeteve *cash*. Nga verifikimi i DV-2004 rezulton se subjekti nuk e ka kryer këtë deklaram, kështu që pretendimi i subjektit nuk qëndron.

2. Për vitin 2006

- 2.1. Akti i paraqitur: Notë verbale, nr. *** prot., datë ***.2.2006, e Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, drejtuar Ambasadës Franceze në Tiranë, në të cilën kërkon pajisjen me vizë të znj. ***.***, për aktivitetin në datat *** shkurt – *** mars 2007 (1 fletë).
 - 2.1.1. Ky akt nuk provon apo përmban të dhëna se kush i ka mbuluar shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe qëndrimit. Duket se personi i lidhur, znj. ***, ka marrë pjesë në këtë aktivitet si juriste në Departamentin e Legjislacionit, Koordinimit dhe Dokumentacionit, por nuk shoqërohet me dokumentacion tjetër mbështetës për të justifikuar shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe dieta. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji.
- 2.2. Akti i paraqitur, Notë verbale, nr.*** prot, datë ***.4.2006, e Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, drejtuar Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, në të cilën kërkon pajisjen me vizë qëndrimi edhe të znj. ***.***, për periudhën ***.5.2006 – ***.5.2006. Bashkëlidhur shkresës gjendet një kopje e certifikatës së znj. *** për përfundimin me sukses të programit ndërkombëtar: "Translating policy into Legislation", organizuar nga "****.***", në datat *** – *** maj 2006 (gjithsej 2 fletë).
 - 2.2.1. Ky dokument provon pjesëmarrjen e znj. *** në aktivitet, por nuk provon mbulimin e shpenzimeve për këtë aktivitet, pasi jo domosdoshmërisht pajisja me vizë nënkupton se shpenzimet e udhëtimit janë të mbuluara. Duket se personi i lidhur, znj. ***, ka marrë pjesë në këtë aktivitet si juriste në Departamentin Juridik dhe të Koordinimit, por nuk shoqërohet me dokumentacion tjetër mbështetës për të justifikuar shpenzimet e udhëtimit,

² E njëjta shumë e marrë në konsideratë në analizën financiare të KPA-së për vitin 2005.

akomodimit dhe të qëndrimit. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji.

- 2.3. Aktet e paraqitura për udhëtimin në periudhën *** – *** nëntor 2006, në Republikën Popullore të Kinës: (i) Shkresë nr. *** prot., datë ***.20.2006, e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, ku njofton mbi seminarin që do të zhvillohet në Pekin, nga data *** – *** nëntor 2006, me temë: “Mbi administrimin e Kryeministrisë”; (ii) Shkresë përcjellëse (urgjent) nr. *** prot., datë ***.10.00, e Këshillit të Ministrave drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), ku cakton znj. *** për ndjekjen e këtij kursi; (iii) Shkresë nr.***, e Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Republikën e Shqipërisë, drejtuar METE-s dhe për dijeni Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në këtë shkresë përcaktohen kushtet e pranimit të pjesëmarrësve dhe mbulimin e shpenzimeve nga Ministria e Tregtisë së Kinës; (iv) Shkresë përcjellëse (urgjent) nr.*** prot., datë ***.4.08, e Këshillit të Ministrave drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) (gjithsej 5 fletë). Komisioneri Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur plotëson kërkesat e hetimit dhe jep informacion mbi mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit dhe qëndrimit të znj. ***, në datat *** - *** nëntor 2006.
- 2.3.1. Lidhur me pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit se në këtë udhëtim znj. *** ka marrë edhe djalin, nisur nga mosha e mitur e tij 2 vjeç, vlerësojmë bindës pretendimin që nuk ka pasur shpenzime udhëtimi për djalin dhe këto duhet t'i zbriten subjektit të rivlerësimit.
- 2.4. Akti tjetër, fotokopje e faqeve të pasaportave për subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten dhe të birin, ku janë vizat dhe vulat hyrëse-dalëse në R. P. të Kinës për datat ***.9.2006 - ***.9.2006. Ky dokumentacion provon realizimin e udhëtimit, por nuk provohet mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit. Për sa i përket shpenzimeve të akomodimit dhe të qëndrimit, marrë parasysh se në këtë periudhë i ati i subjektit të rivlerësimit ka mbajtur funksionin e Ambasadorit në R. P. të Kinës, pretendimi i subjektit vlerësohet i besueshëm, por nuk provohet me dokumentacion mbulimi i shpenzimeve për biletat e udhëtimit nga i ati për familjen e subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji, duke zbritur akomodimin pranë shtëpisë së babait të subjektit të rivlerësimit.
- 2.5. Lidhur me pretendimin për rilogaritjen e të ardhurave të bashkëshortes, subjekti për vitin 2006, referuar zërit: “Të ardhura të bashkëshortes” pretendon se të ardhurat e bashkëshortes duhet të konsiderohen të ardhurat e dala nga sistemi bankar. Ky zë nuk duhet të jetë 955.66 lekë, por 1.027.023 lekë, pra 71.359 lekë më shumë. Komisioneri Publik, referuar akteve në dosje, mbi të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, dorëzuar në ILDKPI, bashkëlidhur D-Vetting, konkretisht shkresës nr. *** prot., datë ***.10.2016, të Kryeministrisë dhe listëpagesës së detajuar bashkëlidhur kësaj shkrese, konstaton se paga neto e znj. ***, për vitin 2006 është 895.121 lekë, paguar nga Kryeministria dhe shuma prej 60.543 lekësh, e ardhur nga mësimdhënia në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin

e Tiranës për këtë vit³, në total shuma 955.664 lekë⁴. Edhe nëse i referohemi dokumentit të *Statement Bankar të *** Bank* për vitin 2006, konstatojmë se shumatorja e pagave të bashkëshortes së subjektit për vitin 2006 është 952.854 lekë, ku përfshihet⁵ edhe pagesa e Fakultetit të Drejtësisë në shumën 60.543 lekë, kredituar në ***.7.2006. Pra, pretendimi i subjektit nuk qëndron.

2.6. *Referuar zërit: “Të ardhura nga paga për subjektin”*, në vitin 2006, subjekti pretendon se referuar dokumentit bankar, të ardhurat nga paga për këtë vit janë në shumën 846.610 lekë dhe jo në shumën 823.664 lekë. Analiza financiare dhe të ardhurat e subjektit, të përfshira në analizë për këtë periudhë janë bazuar në dokumentin ligjor “Vërtetim i pagës, datë ***.10.2016, lëshuar nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë dhe dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur Deklaratës “Vetting”, për vitin 2006 janë në shumën 823.664 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga neto për vitin 2006, shumën 823.664 lekë.

2.6.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, të ardhurat neto nga pagat, të vlerësuara sipas llogarisë bankare, me përshkrimet përkatëse⁶, nuk japin dhëna të sakta mbi natyrën e pagesave, ndërkohë që në dosjen hetimore ekziston një vërtetim zyrtar nga institucioni, mbi të ardhurat neto nga pagat. Komisioneri Publik konkludon që subjektit të rivlerësimit duhet t’i merren në konsideratë të ardhurat e vitit sipas *statement-it* bankar, në shumën 846.610 lekë.

3. Për vitin 2007

3.1. Aktet e paraqitura për udhëtimin në periudhën ***.11.2007 - ***.11.2007 në SHBA, janë: (i) Notë verbale, nr. *** prot, datë ***.10.2007, e Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, drejtuar Ambasadës së Republikës së SHBA në Tiranë, në të cilën kërkohet pajisja me vizë për znj. ***.*** dhe bashkëshortin, z. D. Peka, për të mbajtur një kolokium në Georgia Southern University, periudha *** - *** nëntor 2007; (ii) letër falënderimi për pjesëmarrjen në aktivitet; (iii) agjendë me aktivitetet për disa ditë, ku përfshihet data *** nëntor; (iv) dokument për znj. *** në lidhje me prezantimin e temës në datë *** nëntor; (v) fotokopje e pasaportave të subjektit të rivlerësimit dhe znj. *** për vizën dhe hyrjen në SHBA; (vi) deklaratë, e dërguar me postë elektronike, e datës ***.9.2020, dërguese ***.*** dhe marrëse znj. ***, ku thuhet se ***.*** deklaroi se zoti D. Peka dhe znj. ***.***, e mbesa e tij, kanë qëndruar në shtëpinë e tij, në *New York*, në nëntor të vitit 2007, dhe sa herë kanë udhëtuar në SHBA. Bashkëlidhur gjendet një fotokopje e pasaportës dhe e patentës së z. ***, koha e lëshimit të të cilave nuk përputhet me periudhën që subjekti dhe bashkëshortja kanë udhëtuar në SHBA. Në vlerësim të Komisionerit Publik, këto akte provojnë qëllimin e vizitës në Georgia Southern University,

³ Referuar dokumentit zyrtar dorëzuar në deklaratën “Vetting”, vërtetim nr. *** prot., datë ***.10.2016, e Fakultetit të Drejtësisë, për të ardhurat nga mësimdhënia, por për periudhën në vitet 2006, 2010 dhe 2016.

⁴ E njëjta shumë e përfshirë edhe në analizën financiare të KPA-së për këtë vit.

⁵ Konstatohet se në datën ***.10.2006 është kredituar llogaria me përshkrim: “Paga ***.***”, në shumën 75.168 lekë, veprim i cili është anuluar po në këtë datë, pra nuk mund të konsiderohet pagesë e ardhur ky veprim.

⁶ Referuar rasteve kur subjektet kanë pretenduar se përshkrimi i dokumentit bankar nuk ka qenë i saktë. Referuar *statement-it* bankar të znj. ***, në këtë vit është konstatuar një kreditim i gabuar i bankës, i cili është korrigjuar, dhe subjekti i referohet veprimeve të bankës për llogaritjen e të ardhurave.

që ndodhet në shtetin e *Georgias*, por nuk japin të dhëna se kush i ka mbuluar shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe të qëndrimit⁷.

- 3.1.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e biletave duhet të llogariten sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji, ndërsa akomodimi dhe qëndrimi duhet t'i zbriten subjektit të rivlerësimit.
- 3.2. Akti i paraqitur për udhëtimin në periudhën ***.4.2007 - ***.4.2007, në Kroaci - korrespondencë nëpërmjet postës elektronike, midis znj. *** me znj. ***, punonjëse në programin EURALIUS, bashkëlidhur një fletë e llogarisë bankare të bankës *** për znj.*** dhe një kopje e kartës së identitetit të znj. *** (gjithsej 4 fletë).
- 3.2.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky akt jep informacion të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit apo qëndrimit, dhe pretendimi i subjektit për udhëtim për shkak pozicionit zyrtar është bindës dhe duhet t'i zbritet subjektit të rivlerësimit.
- 3.3. Akti i paraqitur për udhëtimet në Hungari (Budapest), Belgjikë (Bruksel), Holandë (Hagë), është: vërtetim, datë ***.9.2020, lëshuar nga znj. ***, ish-zëvendës drejtuese e Ekipit dhe Koordinatorë e Programit të Trajnimeve të SMEI 2007 – 2009. Në përmbajtje të vërtetimit, ndër të tjera, thuhet se znj. *** ka marrë pjesë në dy vizita studimore në Hungari, në datat *** - *** qershor 2007 dhe Bruksel-Hagë, në datat *** - *** tetor 2007. Në këtë akt, znj. *** deklaron se të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes në këto aktivitete janë mbuluar nga fondet e Projektit SMEI (1 fletë).
- 3.3.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik këto shpenzime duhet t'i zbriten subjektit të rivlerësimit.
- 3.4. Akti tjetër, fotokopje e faqeve të pasaportave për subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten dhe të birin, ku janë vizat dhe vulat hyrëse - dalëse në R. P. të Kinës për datat *** - ***.7.2007 dhe *** - ***.9.2007. Ky dokumentacion provon udhëtimin, por nuk provohet mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit. Për sa i përket shpenzimeve të akomodimit dhe qëndrimit, marrë parasysh se në këtë periudhë i ati i subjektit të rivlerësimit ka mbajtur funksionin e Ambasadorit në R. P. të Kinës, pretendimi i subjektit vlerësohet i besueshëm dhe duhet t'i zbriten subjektit të rivlerësimit.
- 3.4.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji.

4. Për vitin 2008, 2009

- 4.1. Aktet e tjera të paraqitura nga subjekti janë për udhëtimet në vitet 2008, 2009, për të cilat subjekti nuk paraqiti pretendime, pasi rezultati i këtyre viteve është me bilanc pozitiv, po listohen si vijon:
 - Akt noterial, Vërtetim i njësisë me origjinalin, datë ***.9.2020, nr. rep. ***, të dokumenteve bashkëlidhur, që janë Certifikata të znj. ***: (i) të vizitës studimore në

⁷ Vendbanimi i z. *** është në Neë York shteti i i Neë York-ut, ndërsa Universiteti është në shtetin e Georgias .

Estoni, datë ***.9 – ***.10 2008; (ii) të ndjekjes së seminarit në Pekin, datë *** qershor 2008; (iii) për pjesëmarrje në seminarin e mbajtur në Berlin *** - *** nëntor 2008 (gjithsej 4 fletë).

- Fotokopje të pasaportës dhe vizat përkatëse të subjektit të rivlerësimit, z. Peka (gjithsej 7 fletë).
- Fotokopje të pasaportës dhe vizat përkatëse të bashkëshortes së subjektit (gjithsej 6 fletë).
- Fotokopje të pasaportës dhe vizat përkatëse të djalit të subjektit (gjithsej 6 fletë).
- Aktet: (i) Memo informuese, datë ***.5.2008 e Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit, drejtuar Kryeministrit, mbi një vizitë pune që do të mbahet në Shkup, Maqedoni dhe grupin e përfaqësues. (ii) Urdhërpagesë e Kryeministrit, datë __5.2008, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në të cilën urdhërohet Sektori i Financës, me aprovim të Kryeministrit, të kryejë veprimet për mbulimin e shpenzimeve financiare: dietë, hotel, shpenzime udhëtimi, për një vizitë pune në Shkup, Maqedoni, në datat *** - *** maj. Në listën e punonjësve është edhe emri i znj. ***. (iii) Mandatpagesë për grupin. (iv) Faturë shpenzimi, shuma në gjuhen maqedonase. (v) Fletë udhëtimi, e plotësuar nga znj. ***, për llogaritjen e dietës. (vi) Faturë hoteli në gjuhën maqedonase; (vii) Listëpagesë, që vërteton se znj. *** është paguar *cash* në shumën 270 euro (gjithsej 8 fletë). (viii) Shkresë nr. *** prot., datë ***.5.2008, e Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit, ku e njofton për vizitën e punës në datat *** - *** maj në Shkup, Maqedoni; (ix) Agjendë e takimit për datën *** dhe *** maj 2008. Seti i dokumenteve për udhëtimin e kryer në Shkup, nga znj. ***, jep të dhëna të mjaftueshme, që tregojnë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga institucioni. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e këtij udhëtimi nuk duhen përfshirë në analizën e vitit 2008.
- Aktet: (i) Urdhërpagesë e Kryeministrit, datë ***.11.2008, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në të cilën urdhërohet Sektori i Financës, me aprovim të Kryeministrit, të kryejë veprimet për mbulimin e shpenzimeve financiare, dieta të plota, në seminarin që do të organizohet në Bon, Gjermani në datat *** – *** nëntor 2008. (ii) Shënim i datës ***.11.2008, ku njoftohet Sekretari i Përgjithshëm për aktivitetin dhe pjesëmarrjen e znj. ***. (iii) Fletë udhëtimi e plotësuar nga znj. ***, për llogaritjen e dietës për ditët e qëndrimit në Gjermani. (iv) Mandatpagesë nr. ***, datë ***.11.08, nënshkruar nga znj. *** për marrjen *cash* të shumës 240 euro. (v) Bileta udhëtimi, të printuara 3 fletë (gjithsej 7 fletë). Seti i dokumenteve për udhëtimin e kryer në Bon, nga znj. ***, jep të dhëna të mjaftueshme, që tregojnë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga institucioni. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e këtij udhëtimi nuk duhen përfshirë në analizën e vitit 2008.

5. Për vitin 2012

- 5.1. Për sa i përket pretendimit të subjektit se në vitin 2012 nuk janë marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga pagat për subjektin dhe bashkëshorten, Komisioneri Publik argumenton se të ardhurat e marra në konsideratë në analizën financiare të subjekteve janë të ardhurat e vërtetuara dhe të argumentuara nga institucionet shtetërore, të dorëzuara nga subjekti bashkëlidhur Deklaratës “Vetting”, dorëzuar në ILDKPI, dhe aktet e administruara nga KPK-ja. Për subjektin: (i) Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë,

periudha 2008 – 2016, shkresa nr. extra prot., datë ***.1.2017⁸; të ardhurat neto për vitin 2012 janë 1.151.365 lekë dhe Vërtetim nga Prokuroria e Përgjithshme, shkresa nr. *** prot., datë ***.10.2016, për periudhën 2009 – 2016, të ardhurat neto për vitin 2012 janë 76.500 lekë, pra gjithsej 1.227.865 lekë; Për bashkëshorten: (i) Vërtetim nga Kryeministria, paga neto për vitin 2012 është 1.275.787 lekë; shkresa nr. *** prot., datë ***.10.2016; (ii) Vërtetim nga Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, shkresa nr. *** prot., datë ***.10.2016, pagesa neto e vitit 2012 është 72.900 lekë; (iii) Vërtetim nga Ministria e Financave, nr.*** prot., datë ***.11.2016, pagesa neto e vitit 2012 është 75.600 lekë; (iv) Shkresë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, shkresa nr.*** prot., datë ***.1.2017, për vitin 2012, shuma neto 213.503 lekë; (v) Vërtetim nga *** Universiteti, shkresa nr. *** prot., datë ***.10.2016, për vitin 2012 të ardhura neto 19.697 lekë; (vi) Vërtetim nga Instituti i Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës, shkresa nr. *** prot., datë ***.10.2016, viti 2012 paguar në shumën 21.600 lekë. Gjithsej shuma 1.679.087 lekë. Bazuar në aktet zyrtare të cituara më sipër dhe vlerat që përmbajnë, pretendimi i subjektit për të ardhurat e vitit 2012 nuk qëndron.

6. Për vitin 2013

6.1. Subjekti ka paraqitur aktet:

- Fotokopje e vërtetimit nr. *** , datë ***.10.2020, nga Agjencia Kombëtare Bërthamore, për një pagesë të kryer ndaj znj. *** në vitin 2013 (1 fletë). Ky akt provon pagesën e kryer dhe ndodhet në dosjen e hetimit të kryer nga Komisioni, si rrjedhim është marrë në konsideratë si e ardhur e vitit 2013.
- Vërtetim nr. *** prot., datë ***.8.2018, nga Fakulteti i Drejtësisë, për znj. *** , në lidhje me pagesat e kryera ndaj znj. *** për vitet 2001, 2013⁹, 2006, 2010 dhe 2016 (1 fletë). Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur Deklaratës “Vetting” ka dorëzuar vërtetimin me nr. *** prot., datë ***.10.2016, të Fakultetit të Drejtësisë, për të ardhurat nga mësimdhënia, por për periudhën në vitet 2006, 2010 dhe 2016. Ky akt është i ndryshëm për nga përmbajtja me aktin e dorëzuar me Deklaratën “Vetting”. Të dhënat e vërtetimit, të dorëzuar nga subjekti në seancën e datës 2.10.2020, në lidhje me të ardhurat vjetore nga mësimdhënia e vitit 2013, nuk përputhen as me deklarin e kryer nga subjekti dhe bashkëshortja në DV-2013.

II. Konkluzione

7. Komisioneri Publik, në vlerësim të sa u administrua dhe u trajtua gjatë shqyrtimit gjyqësor, në raport me shkaqet e ankimit, si dhe për sa u administrua nga trupi gjyqësor në seancat e zhvilluara, parashtron konkluzionet përfundimtare si vijon:

- 7.1. Lidhur me kredinë me kushte lehtësuese, të datës ***.7.2010, gjatë shqyrtimit gjyqësor u arrit të provohej se **aplikimi** është konform kërkesave të VKM-së nr. 600/2007, lidhur me kategorinë e subjekteve përfitues për shkak pozicioni të barasvlershëm, të znj. ***.*** me atë të drejtorit.

⁸ Dokumenti është firmosur nga zoti D. Peka, si drejtues i këtij institucioni.

⁹ Në DV-2013, nuk është deklaruar e ardhura e përfituar nga mësimdhënia në Fakultetin e Drejtësisë në UT.

7.2. **Lidhur me pamjaftueshmërinë financiare për periudhën 2003 – 2016**, Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara dhe të vëna në dispozicion nga *Komisioni*, përfshirë deklaratimet e subjektit dhe të personave të lidhur, në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore të subjektit, për periudhën 2003 - 2016, në D-Vett., ka konstatuar pamjaftueshmëri financiare apo pamundësi të mbulimit me burime nga të ardhura të ligjshme të pasurive të krijuara (të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete në bankë) kursimet *cash* të deklaruara dhe shpenzimet e kryera.

7.2.1. Gjithashtu, bazuar në rezultatet e hetimit dhe vendimin e Komisionit nr.112, datë 4.3.2019, nga Komisioneri Publik u konstatua se analiza financiare, e paraqitur në vendim, përfshinte vetëm periudhën 2003 - 2009. Për të pasur një konkluzion më të saktë dhe për të qartësuar situatën financiare të subjektit, Komisioneri Publik iu drejtua Kolegjit me kërkesën për kryerjen e një analize financiare për të gjithë periudhën e hetimit 2003 – 2016.

7.2.2. Nga ana e Kolegjit, në seancën e datës 14.9.2020, me vendim të ndërmjetëm, u vendos të kryhej analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën e hetimit 2003 – 2016. Pas njohjes me analizën financiare të kryer nga Kolegji për periudhën 2003 – 2016, Komisioneri u shpreh dakord me analizën dhe rezultatet e saj, por vazhdon të mbajë të njëjtin qëndrim për sa vijon:

- Referuar vitit 2005, që rezultoi me diferencë negative, por jo vetëm, Komisioneri publik argumenton se në vitet ku analiza financiare rezulton me balancë negative apo me mungesë burimesh nga të ardhura të ligjshme, atëherë kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti, por që gjenden jashtë sistemit bankar, nuk mund të konsiderohen si burim të ardhurash të ligjshme dhe të gjenerohen në vitet në vazhdim.
- Gjithashtu, referuar analizës së vitit 2010 lidhur me likuiditetet *cash* të deklaruara nga subjekti¹⁰, por që gjenden jashtë sistemit bankar, u konstatua se nuk ishin përfshirë. Komisioneri Publik mban të njëjtin qëndrim që në analizën e vitit 2010 duhet të përfshihen likuiditetet *cash* sipas deklarimeve të subjektit në DV periodike.

7.2.3. Komisioneri Publik, për sa i përket likuiditeteve *cash* të deklaruara nga subjekti, konstaton se ka nuk përputhen deklaratimet e subjektit, referuar: (i) parashtrimeve të subjektit të datës 2.10.2020 dhe analizës financiare shoqëruese; (ii) shpjegimeve të dhëna në Komision lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*¹¹; (iii) deklarimeve të kryera në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, të kryera nga subjekti në vitin përkatës të periudhës së deklaruar. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, likuiditetet *cash*, që gjenden jashtë sistemit bankar, duhet të bazohen në deklaratimet e kryera nga subjekti, në deklaratat e interesave private/periodike vjetore. Ky vlerësim bazohet edhe në jurisprudencën e krijuar për trajtimin e likuiditeteve *cash* nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, ¹² gjatë procesit të rivlerësimit.

¹⁰ Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2010, subjekti ka deklaruar: “Para të kursyera *cash* nga paga”, në shumën 1.000.000 lekë dhe “Para të kursyera *cash* nga kredia në ***”, në shumën 1.500.000 lekë.

¹¹ Nëse i referohemi shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit të datës 24.8.2018, atëherë gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë në fund të vitit 2016 është rreth 1,500,000 lekë. Nëse ky deklaram është i saktë, atëherë kjo shumë nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në datën 24.1.2017, por as si pakësim *cash*-i në deklaratën vjetore të vitit 2016.

¹² Vendimet (JR) nr. 11/2019, në prg. 27; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59; (JR) nr. 7/2019, prg. 39.

7.2.4. Referuar analizës financiare e periudhës së hetimit 2003 – 2016, të kryer nga Kolegji, dhe diferencës negative e saj, për periudhën 2003 – 2016, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (të luajtshme, paluajtshme, likuiditetet në bankë), kursimet e deklaruara dhe shpenzimet e kryera.

7.2.5. Në përfundim, Komisioneri Publik konstaton se: *subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3, dhe nenit 33, pika 5, germa “a”) e ligjit nr. 84/2016.*

7.3. *Lidhur me aftësitë profesionale, tri çështjet në ankim që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale, janë:*

Së pari**, praktika e përzgjedhjes dhe punësimi i z. ***,, si dhe kohëzgjatja e saj, transferuar për inspektim pranë organit kompetent, referuar pikës 2 të vendimit nr.112/2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Gjatë gjyqimit u provua se çështja është arkivuar nga organi kompetent, Prokuroria e Përgjithshme, në periudhën kalimtare, por nuk u provua nëse Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi kushtetues, që ka në përgjegjësi marrjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve, ka disponuar më tej lidhur me këtë vendim. Në vlerësim të Komisionerit Publik, kjo çështje rezulton bindëse.*

***Së dyti**, denoncimi nga familja ***, duke pasur parasysh se analiza e këtij rasti lidhej me dy momentet: (1) procedurat e brendshme për paraqitjen e rekursit; (2) së dyti, hapat e ndërmarrë nga Drejtuesi për këtë shkëlqje, të bërë nga Prokurori i Apelit, gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi bindës kundërshtimi i subjektit të rivlerësimit për momentin e parë, ndërsa për momentin e dytë nuk pati sqarime nga subjekti i rivlerësimit. Për këtë arsye, në vlerësim të Komisionerit Publik, kjo çështje rezulton bindëse.*

Së treti**, denoncimi anonim për tërheqjen nga ankimi për të pandehurin ***,, për të cilin kemi deklaruar se do të shpreheshim pasi të dëgjonim subjektin, referuar shpjegimeve të tij lidhur me ndryshimet në legjislacionin procedural penal, sipas të cilit prokurori në gjykim është i pavarur dhe nuk i diskuton qëndrimet e tij për çështje konkrete me prokurorin më të lartë, rezulton bindëse.*

8. Në përfundim, mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në bazë të nenit 66, pika 1, germa “b”, e ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, zotin Dritan Peka, dhe shkarkimin e subjektit nga detyra.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA